



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1683 Prot

Vlorë, më 09.02 2023

Lënda : Mbi miratimin e planit të pranimit/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2023.

Në zbatim të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neni 18, "Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil", Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil" dhe VKB nr. 87, datë 23.12.2022 "Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara - 2023", miratohet plani i pranimit/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2023 si më poshtë;

Bazuar në gjurmën a) "*Mbushjen e moshës së pensionit të nëpunësit civil*" të pikës 3, të VKM nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", në stafin e Bashkisë Vlorë, për vitin kalendarik Janar-Dhjetor 2023, janë **3 punonjës** të cilët kanë mbushur moshën e pensionit **(3 pozicione)**.

Bazuar në gjurmën b) "*Parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil*", të pikës 3, të VKM nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", pozicionet vakante të planifikuara për vitin kalendarik Janar-Dhjetor 2023, janë **31 pozicione**. Proçedurat e rekrutimit për plotësimin e vendeve vakante në kategorinë ekzekutive për vitin 2022, kanë përfunduar pa kandidatë, pa fitues dhe me listë fituesish (6 kandidatë).

Gjithsej vende vakante në shërbimin civil për periudhën Janar- Dhjetor 2023 në Bashkinë Vlorë janë **34 pozicione**.

**PLANI VJETOR I PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL TË BASHKISË VLORË PËR
VITIN 2023**

Vende të lira në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil	Kategoria	Numri i Vendeve Vakante	Klasa	Lloji i procedurës
Drejtor drejtorie	Nivel i mesëm drejtues	5	II/b	Lëvizje paralele/Ngritje në detyrë
Përgjegjës sektori	Nivel i ulët drejtues	2	III/a	Lëvizje paralele/Ngritje në detyrë
Specialist	Nivel Ekzekutiv	27	III/b IV/a IV/b	Lëvizje paralele/Pranim në shërbim civil

KRYETAR
Dritan Leli

